

NJOFTIM

Sot, më datë **30.06.2023**, ora **09:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Marsela Dervishi (Relatore);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Edlira Petri (Anëtare);**
- 5. Blerona Hasa (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar pranë sallës “Amfiteatri”, në selinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me adresë: Godina Poli i Drejtësisë, Rr. “Ana Komnena”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.35 Regj.Themeltar, Datë 19.06.2023 Regjistrimi, me:

PADITËSA: - Lefter Maliqi, përfaqësuar nga Av. Arben Llangozi.
- Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Av. Franci Nuri.

TË PADITUR: - Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Znj. Ina Osmanaj.

PERSON I INTERESUAR: Subjekti Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Av. Maringlen Legisi.

OBJEKTI: Shfuqizimin/anullimin dhe/ose konstatimin e pavlefshmërisë absolute tërësore dhe/ose të pjesshme të Vendimit nr.178, datë 13.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur si më poshtë:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të ZAZ-së nr. 64, bashkia Kuçovë, qarku Berat “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë” dhe duke u shpallur unë Lefter Maliqi si fitues i zgjedhjeve vendore në Bashkinë Kuçovë për mandatin e kryetarit të kësaj Bashkie.
2. Rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-në nr. 64, të gjitha QV-të, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.
3. Pavlefshmëri e vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë”.
4. Konstatim i pavlefshmërisë së vendimit të KQZ-së ku është emëruar sekretari i KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi.

5. Pavlefshmëri e vendimit të KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 10:00 deri në orën 12:30.
6. Pavlefshmëri e pjesëshme e fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashkie për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për bashkinë Kuçovë, qarku Berat, Kreshnik Hajdari .
7. Pavlefshmëri e veprimit juridik, formulari i dekriminalizimit, në emër të Kreshnik Hajdarit dorëzuar pranë KQZ referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZA LIGJORE: Neni 124 e vijues i Kodit Zgjedhor, nenet 4, 13, 14, 23, 24, 90, 109, 116 të Kodit të Procedurave Administrative.

me Vendimin Nr. 33, datë 30.06.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

VENDOSI

1. Rrëzimin e padisë së paditësave Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe Lefter Maliqi.
2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palëve paditëse solidarisht.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 30.06.2023.

Tiranë, më 30.06.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë